

# Financimi gjatë fushatave elektorale



## RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023



QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

AUTOR  
ILDA METHASANI

Hyrje	3
1. Financimi i fushatave elektorale	3
2. Financimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	5
3. Aktualiteti nën optikën e ekspertëve	10
4. Financat gjatë fushatës zgjedhore	11
Përmbledhje	17
Bibliografia	19

## Hyrje

Shqipëria është në prag të zgjedhjeve lokale të vitit 2023 dhe një nga problemet më të mëdha vijon të mbetet financimi i fushatave zgjedhore. Pavarësisht përmirësimeve të vazhdueshme që i janë bërë Kodit Zgjedhor (në vitin 2020), në Shqipëri financimi në fushatat zgjedhore vijon të mbetet një problem shqetësues. Në kuadër të transparencës së financimeve në zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në një raport të fundit për zgjedhjet e vitit 2021, konstatoi se kishte fshehje të dukshme të burimeve të financimit dhe shpenzimeve.

Të gjendura vazhdimisht nën akuza jo tërësisht të pabaza për përdorimin e parave të pista dhe të paligjshme për financimin e fushatave elektorale, partitë politike shqiptare përgjatë viteve të fundit kanë shprehur një shkallë gatishmërie për të rritur transparencën e financimeve të tyre. Megjithatë, raporte të organizatave ndërkombëtare që monitorojnë proceset elektorale mbështesin faktin se përmirësimet ligjore nuk kanë qënë të mjaftueshme, pasi ende ka fshehje të financimit dhe shpenzimeve nga ana e partive, dhe për më tepër sanksionet janë të dobëta. Eksperienca e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me monitorimin e zgjedhjeve tregojnë se transparenca e partive politike si dhe mekanizmat e kontrollit mbi financat e partive e bëjnë efektivisht të pamundur dallimin e 'parave të pista' në zgjedhje nga financimet e ligjshme. Ekspertët shohin me shqetësim, se depërtimi në fushatë elektorale i parave që vijnë nga bota e krimit dhe korrupsionit, i hap rrugë korrupsionit në çdo hallkë të qeverisjes.

### 1. Financimi i fushatave elektorale

**Parti politike:** Grup personash të organizuar për të fituar dhe ushtruar pushtet politik.

*“Partitë politike, në veprimtarinë për arritjen e qëllimeve të tyre, përdorin **vetëm** mjete dhe metoda demokratike.”*

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> [Ligji-per-partite-politike-2020\\_1.pdf \(kqz.gov.al\)](#)

Për të fituar mbështetjen e qytetarëve dhe për të krijuar një organizatë të konsoliduar politike, partitë dhe kandidatët e tyre kanë nevojë për burime të ndryshme. Kjo varësi për të krijuar dhe pasur burime (kryesisht financiare) që faktorizojnë suksesin e veprimtarisë politike mund të paraqesin rreziqe serioze korrupsioni për cilësinë e qeverisjes dhe të demokracisë në vend. Partitë politike shërbejnë si një mjet i nevojshëm dhe i domosdoshëm që qytetarët mund të përdorin për të përfaqësuar vullnetin e tyre në procesin politik. Pranadaj një proces i tillë duhet të ketë standarte të larta të integritetit dhe të transparencës. Në këtë pikë, transparencja është një element thelbësor në monitorimin e qarkullimit të parasë në politikë, për të ndihmuar në rivendosjen e besimit të politikanët dhe për të siguruar një proces në përputhje me parimet demokratike të konkurrencës së ndershme.

Disa nga problemet kryesore që shfaqen nga mungesa e transparencës:

- Rrezik korrupsioni për cilësinë e qeverisjes dhe të demokracisë,
- Bie ndesh me parimet demokratike të konkurrencës së ndershme në zgjedhje dhe mund të çënojë edhe përfaqësimin politik,
- Rrezikohet më tej besimit të politika dhe politikanët.

Disa nga arsyet se pse është e domosdoshme përmirësimi i mëtejshëm ligjor dhe praktikave monitoruese (sanksionet) të financimit të partive politike:

- Parandalimi i abuzivizmit,
- Fuqizimi i një konkurimi politik të drejtë,
- Fuqizimi i votuesve nëpërmjet rregullave ligjore të transparencës dhe ndërshikimit; dhe
- Fuqizimi i partive politike si aktorë efektivë të demokracisë nëpërmjet rritjes së integritetit dhe demokracisë së brendshme.

Disa nga rregullat bazë mbi financimin e partive politike:

- Financimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore rregullohet me Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", si dhe me Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike".
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka autoritetin dhe përgjegjësinë **të mbikëqyrë, të kontrollojë dhe të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë dhe jashtë periudhës së fushatës zgjedhore**, si edhe të hartojë aktet nënligjore në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe ligjit "Për Partitë Politike."

- Partitë politike për kryerjen e veprimtarisë vjetore dhe subjektet zgjedhore në mbështetje të fushatës zgjedhore financohen **nga fonde publike (buxheti shtetit) si dhe nga fonde jopublike.**
- Kategoritë e subjekteve që ndalohen për të financuar fushatën zgjedhore janë:
  - individë apo kompani **që kanë përfituar fonde publike** në 3 vitet e fundit me vlera mbi 10 milion leke nga kontrata publike apo koncesione;
  - individë apo kompani të cilët ushtrojnë veprimtari në **fushën e medias;**
  - individë apo kompani që kanë qenë **partner me fonde publike** në projekte të ndryshme;
  - individë apo kompani që kanë **detyrime monetare ndaj buxhetit të shtetit** apo çdo **institucioni publik.**
- Ndalohet financimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore nga **individë apo kompani të huaja.**
- Vlera maksimale e dhurimit për fushatë zgjedhore nuk duhet të **kalojë 1 milionë lekë nga i njëjti dhurues** për subjektet zgjedhore përfshirë edhe kandidatët e tij.
- Për subjektet zgjedhore dhurimi me vlerë më të madhe **se 50,000 lekë bëhet vetëm në llogari bankare të posaçme dhe të dhënat e dhuruesit bëhen publike.**
- **Raportet financiare vjetore** si dhe raportet financiare të **fushatës zgjedhore publikohen në faqen zyrtare** të internetit të KQZ-së.

## 2. Financimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Ai financohet nga Buxheti i Shtetit dhe është institucion i pavarur. Financimi nga buxheti i shtetit për KQZ-në ndryshon nga viti në vit e sidomos në vitet zgjedhore. Dy zërat për KQZ që financohen nga buxheti janë: “planifikim, menaxhim dhe administrim” si dhe “zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.”

Le të shohim buxhetin total të alokuar ndaj KQZ-së për një periudhë nga 2008 deri në vitin 2023, duke ju referuar buxhetit të konsoliduar fillestar. Natyrisht që vitet zgjedhore janë vitet me vlerën më të lartë të buxhetit të alokuar ndaj komisionit të zgjedhjeve. Konkretisht, viti 2019 renditet si vitit me buxhetin më të lartë të parashikuar, me 762.1 milionë lekë. Kjo shuma është më e lartë e parashikuar ndonjëherë. Zëri “Planifikim, menaxhim dhe Administrim” shënon vlerën 162 milion lekë ndërsa Zëri “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale” financohen në vlerën 600 milion.

Ndiqet nga vitet 2017, 2013, 2011 dhe 2009, 2015 ku mesatarisht buxhetet e alokuara për secilin vit janë rreth vlerës së 709.8 milionë lekëve. Nësë ndalemi vetëm në zërin “planifikim, menaxhim dhe administrim” vihet re që në harkun kohor të pesëmbëdhjetë viteve, financimi më i lartë shënohet në vitin 2022 (274 milionë lekë), vit i cili edhe pse nuk është vit i mbajtjes së ndonjë procesi zgjedhor shënon përgatitje dhe kosto për zgjedhjet parlamentare të vitit pasardhës 2023. Për sa i përket financimit për zërin “zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale,” vëmë re që shuma e alokuar për të në 4 vitet e fundit (2023-2020) paraqitet në vlerën zero ndërsa në vitet e mëparshme që shoqerohen me zgjedhje lokale ose qëndrore shuma e financimit paraqitet e njëjtë prej 600 milion lekë.

Vitet	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	Total
2023	233800	0	233800
2022	274940	0	274940
2021	181500	0	181500
2020	133100	0	133100
2019	162100	600000	762100
2018	128300	0	128300
2017	139300	600000	739300
2016	90000	0	90000
2015	92800	600000	692800
2014	91080	0	91080
2013	121000	600000	721000
2012	86960	0	86960
2011	100200	600000	700200
2010	97560	0	97560
2009	95800	600000	695800
2008	124200	0	124200

**Burimi:** Ministria e Financave

Sipas raportit për vitin 2021, fondi total i akorduar për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 është 3.877 miliardë Lekë. Realizimi i Fondit



total të Buxhetit të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021 deri në datën 31 Dhjetor 202:

- Pagat (Pagat personelit te perkohshem ne KQZ dhe Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNVve, ZR, trajnuesve te KZZ,KQV,GNV) 272,740,690
- MALLRA & SHERBIME (Fletë votimi & shabllonë të posacëm për votuesit e verbër, Kode sigurie, Bojë timbruese, Vula për KZAZ-të dhe KQV-të, Dhoma të fshehta, Kuti kartoni për transportin e bazës materialë zgjedhore, Shtypshkrime, Kancelari, Materiale promocionale dhe shërbimet të ndryshme) 612,659,302
- INVESTIME (Kamera per sistemin video-monitorimin ne qendrat e Votimit, Projekti pilot i votim numerimit elektronik ne KZAZ nr.40, Projekti i identifikimi elektronik i zgjedhësve) 2,916,129,079

Ndërsa për kostot e këtij procesi zgjedhor kreu i KQZ bëri me dije që sipas tij shkojnë në 2.3 miliardë lekë.<sup>2</sup>

*“Kemi disa të dhëna me buxhetin dhe koston e këtij procesi zgjedhor. Sipas vlerësimit të KQZ dhe sipas kërkesave që KZQ i ka bërë Kuvendit, kosto e zgjedhjeve të ardhshme është 5.3 miliardë lekë prej të cilave:*

- 3 miliardë është kosto për projektin e votimit elektronik në 6 bashki të tjera, në rast se ky projekt do realizohet do ketë këtë kosto,
- 603 milionë lekë do kushtojë implementimi i sistemit të identifikimit elektronik;
- 124 milionë është kostoja për kamerat në vendet e numërimit të votave,
- 150 milionë është kosto për kamerat në qendrat e votimit;
- 202 milionë është kostoja për projektet e edukimit dhe informimit të zgjedhësve;
- 210 milionë është kostoja për pagesat e komisionerëve. Janë 352 punonjës që do angazhohen nga KQZ me kohë të pjesshme.

### **Fondi Shtetëror që përfitojnë Partitë Politike për vitin 2022**

Kodi Zgjedhor, Ligji për Partitë Politike dhe Vendimet e Komisionit Reformator i njohin të drejtë Partive pjesëmarrëse në zgjedhje parlamentare të përfitojnë para nga buxheti i shtetit çdo vit. Shpërndarja bëhet në bazë të performancës së partisë në zgjedhje ku vlerësimi kryesor është sipas numrit të deputetëve. Përveç numrit të deputetëve partitë bëhen përfituese nga Fondi Shtetëror edhe nëse

<sup>2</sup> [Zgjedhjet vendore/ Celibashi: Kosto 2.3 miliardë lekë, më 14 prill nis fushata zgjedhore! Në 9 prill lista përfundimtare e zgjedhësve | RTSH Lajme](#)

kanë marrë më shumë se dhjetë mijë vota apo nëse kanë marrë më shumë se një përqind të votave.

Në finale shpërndarja e parave dhe vlerësimi sipas formulës bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky i fundit me ka bërë vlerësimin e fondeve sipas performancës për njëmbëdhjetë parti ku dhjetë janë parti parlamentare dhe një është parti jo parlamentare por përfituese e mbi dhjetë mijë vota.

Në total fondi për Partitë Politike për vitit 2022, i miratuar edhe në Ligjin për Buxhetin e Shtetit është 345 600 000 Lekë (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë). Përfituesit sipas vlerës janë si vijon:

Partia	Buxheti i shtetit
Partia Socialiste	151 494 783
Partia Demokratike	104 926 170
Lëvizja Socialiste për Integrim	15 577 215
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	9 753 657
Partia Republikane e Shqipërisë	13 223 679
Partia Lëvizja e Legalitetit	8 018 647
Partia Social Demokrate	12 266 269
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	8 018 647
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	8 018 647
Partia Nisma Thurje	6 283 636
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	8 018 647
<b>Totali</b>	<b>345 600 000</b>

Ku 70 përqind të fondit total e përfitojnë Partitë Parlamentare sipas numrit të deputetëve të fituar sipas Sistemit Zgjedhor. Fondi në masën 20% përfitohet nga Parti që kanë fituar mbi 10 mijë vota ndërsa 10 përqind në finale ndahet mes partive që kanë marrë mbi një përqind të totalit të votave.

Sa i përket buxhetimit për parti që kanë marrë mbi 10 mijë vota, listës së partive parlamentare i shtohet edhe Partia Nisma Thurje e cila ka marrë 10 217 vota por nuk ka arritur të dërgojë një deputet në kuvend. Vendimi komisionerit ka alokuar fondin 6 283 636 Lekë (gjashtë milion e



dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë lekë) për këtë parti dhe po kaq për secilën parti që e ka arritur këtë sasi votash.

Ndërkohë parti që ndajnë pjesën takuese për shkak të kalimit të pragut të 1 përqind vota janë vetëm katër e konkretisht Partia Socialiste 48.67 përqind, Partia Demokratike 39.43 përqind, partia Lëvizja Socialiste për Integrim 6.81 përqind dhe partia Social Demokrate me 2.24 përqind.

### Raporti i Fundit i KQZ-së<sup>3</sup>

Monitoruesit e KQZ-së përpiluan raporte monitorimi (raporte periodike çdo 10 ditë, raporte për shkelje flagrante rast pas rasti si dhe raportin përdundimtar) gjatë gjithë periudhës së para dhe gjatë fushatës, duke evidentuar dhe dokumentuar aktivitetet e partive politike/kandidatëve në 12 qarqet.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, morën pjesë 32 (tridhjetë e dy) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidat të propozuar nga zgjedhësit.

Pas dorëzimit të raporteve financiare vjetore për vitin kalendarik 2020 nga partitë politike që rezultojnë të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjqësor, Tiranë, referuar ligjit për Partitë Politike, KQZ përzgjodhi me short 17 ekspertë kontabël të licensuar për të kryer auditimin e 131 (njëqind e tridhjetë e një) Partive Politike. Me vendim nr. 430 datë 22.07.2021, i Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve, "Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020, si edhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre", vendosi masa administrative:

- gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë për 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike**, që nuk kanë dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin kalendarik 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,
- si dhe gjobë në masën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për 4 (katër) partitë politike** që e kanë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Vendimi i Komisionerit u ankimua në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) nga ana e 20 (njëzetë) partive politike të përmbledhura në 12 (dymbëdhjetë) kërkesa ankimore. Në përfundim të shqyrtimit administrativ KAS vendosi: Ndryshimin e

<sup>3</sup> [Raporti vjetor i KQZ 2021](#)

vendimit nr. 430, datë 22.07.2021, "Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pranimin e kërkesës ankimore, heqjen e sanksionit administrativ për 2 parti politike. Pranimin pjesërisht të kërkesave ankimore të 3 (tre) partive politike dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Rrëzimin e kërkesës për 2 (dy) parti politike dhe lënien në fuqi të sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 430, datë 22.07.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për 13 (trembëdhjetë) parti politike dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

### 3. Aktualiteti nën optikën e ekspertëve

Disa nga shqetësimet kryesore që janë ngritur dhe vijojnë të ngrihen nga ekspertët mund të përmbliidhen në disa aspekte kryesore si më poshtë:

- **Rregullat mbi financimin e fushatave duhet të harmonizohen ndërsa legjislacioni detyësor duhet të zhvillohet për të siguruar një metodologji të shëndoshë dhe akses në informacion të plotë mbi financimin e fushatave për ekspertët e financave dhe votuesve para ditës së votimit. Transparenca e donacioneve të fushatës mbeti e kufizuar për shkak të mungesës së kërkesave për deklarim gjatë fushatës elektorale (OSBE-ODIHR)**
- Një problem i rëndësishëm është **dallimi i financave të partive nga financat private të kandidatëve**. Këta të fundit nuk kanë detyrim të raportojnë më vete ndërsa partitë nuk përfshijnë fondet e kandidatëve në vetëdeklarimet e tyre. Integriteti financiar i kandidatëve garues dhe burimet financiare të subjekteve zgjedhore janë dy çështje që mbartin pikëpyetje të forta në lidhje me kapjen e tyre nga interesa privatë apo të jashtëligjshëm. (KVV)
- **Partitë politike shqiptare që nga vitit 2011, kanë për detyrë të raportojnë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të ardhurat dhe shpenzimet e tyre financiare (deklarim vjetor për financat e veta dhe deklarime të veçanta për fushatat zgjedhore)**. Veprimtaria financiare e subjekteve zgjedhore pritet t'i nënshtrohet një mekanizmi kontrolli të ekspertëve kontabël dhe financiarë të përzgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

por i cili vlerësohet si tërësisht jo efikas në garantimin e transparencës dhe zbatimit të rregullimeve ligjore.

- **Raportet vjetore të partive politike si dhe raportet e fushatave zgjedhore publikohen në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.** Në këto raporte vërehet se një numër i konsiderueshëm partish politike, ndonëse garojnë rregullisht në zgjedhje, deklarojnë zero të ardhura dhe zero shpenzime. Audituesit e pavarur të cilët paguhen për kontrollin e vërtetësisë së bilanceve të deklaruara të këtyre partive, raportojnë vërtetësi të plotë të këtyre bilanceve. Por edhe në rastet e partive të mëdha, të cilat deklarojnë të ardhura dhe shpenzime, audituesit nuk kanë gjetur deri më sot ndonjë pasaktësi, e aq më pak, shkelje.
- Organizatat ndërkombëtare që monitorojnë proceset elektorale vërejnë se megjithë përmirësimet ligjore, ende ka fshehje të financimit dhe shpenzimeve nga ana e partive, dhe se **sanksionet janë të dobëta.**
- Në këtë kontekst **proçesi i korrupsionit zgjedhor** është një proçes i cili nuk garanton asnjë strukturë të shtetit që të jetë strukturë e pakorruptuar. **Nëse kemi korrupsion në zgjedhje, kemi në qeverisje, që ka të bëjë me të gjitha format, qoftë në qeverisjen qëndrore, atë lokale, por dhe në atë që quhet parlamentarizëm në nivelin e hartimit të ligjeve. (ODA)**
- Kandidatët mundohen t'i fshehin financimet duke anashkaluar raportimin, duke thënë që nuk është aktiviteti ynë si kandidatë, por i partisë politike. Nga ana tjetër nga strukturat e partisë duhet t'i ushtrohet presion kandidatëve, që të gjitha paratë t'i deklarojnë si një zë më vete dhe jo të përfshihen brenda shpenzimeve të subjektit politik. (VVV)
- Në mbikqyrjen e financave të partive, thonë ekspertët, përveç KQZ kanë rol dhe institucione të tjera si Prokuroria, Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe se depërtimi i parave nga bota e krimit dhe korrupsionit në fushatë mbetet shqetësim.

#### 4. Financat gjatë fushatës zgjedhore

Transparenca e financimit të partive politike është domosdoshmëri jo vetëm gjatë fushatave elektorale por edhe gjatë gjithë veprimtarisë së tyre. E megjithatë, ndër vite akoma nuk i është kështuar vemendja e nevojshme dhe nuk janë marrë masa të dukshme në përmirësimin e transparencës së financave të partive politike në vendin tonë.

Ndër vite problematikat kryesore kanë rezultuar të përsëritura. Sipas një artikulli nga Open Data Albania evidentohen disa problematika (zgjedhjet e vitit 2017) të përmedura si më poshtë:

- **Partitë e mëdha kanë deklaruar si dhurim në natyrë** (vënë në dispozicion një shërbim apo të mirë materiale pa kundërshtëpërblim monetar) të gjitha zyrat elektorale të përdorura në fushatën zgjedhore. **Donatorët në natyrë për këtë kategori shpenzimi mbeten anonim pasi partitë nuk kanë bërë evidentim me faturë të rregullt për këto lloj dhurimesh (në natyrë).**
- Mos mbajtja e faturave të rregullta për rastet është shkelje e rregullave të kontabilizimit dhe evidencës së raportit financiar. Deklarimi final nga partitë është bërë mbi përlogaritjet që kanë bërë audituesit monitorues të emëruar përpara fushatës për verifikime në terren.
- Partitë deklarojnë pak të ardhura të vëna në dispozicion për fushatën dhe këto kryesisht të ardhura të cilat janë financime publike nga buxheti i shtetit. Vlera të krijuara nga donacionet dhe nga të ardhura të vetë partisë janë të pakta. Ky fakt lë dyshime se partitë konsumojnë dhurime dhe shpenzime të padeklaruar.
- Një fakt shqetësues është edhe marrëdhënia ndërmjet subjekteve elektorale dhe mediave. Secila nga partitë ka mbyllur fushatën zgjedhore me fatura të palikujduara dhe me vlera konkrete ndaj televizioneve. Në disa raste këto fatura të papaguara janë vetdeklaruar nga partitë dhuratë e në raste të tjera si detyrim i pashlyer. Kodi zgjedhor nuk lejon dhurata (donacione) nga subjekte mediatike dhe aksioner të tyre në favor të subjekteve elektorale.
- Partitë politike kanë vlera të ndryshme në raportimet e bëra në faqen e KQZ (on line) dhe në deklarimet e bëra përmes raporteve të auditimit kontabël. Kjo mos kordinancë në vlera përkon me disa deklarime shitesë të bëra më vonë të cilat partitë politike i kanë plotësuar me të dhëna kryesisht për të ardhura dhe shpenzime në natyrë (të dhuruara jo kundrejt pagesës). Ky element shfaq problematikën e fiktivitetit dhe jo seriozitetit në raportim. Disa nga ekspertët kontabël të pavarur kanë rekomanduar rishikim të deklarimeve online për partitë e caktuara.

## Zgjedhjet e vitit 2021<sup>4</sup>

### Të ardhurat dhe shpenzimet:

Partia	Të ardhura	Shpenzime
Partia Socialiste	176538087	172046612
Partia Demokratike	47625660.14	47625660.14
Lëvizja Socialiste për Integrim	35955359	35955359
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	16385217	16385217
Partia Republikane e Shqipërisë	4235440	3684258
Partia Bindja Demokratike	2285550	2780463
Partia Fryma e Re Demokratike	2254832	1703500
Partia Social Demokrate	1629360	0
Partia Demokristiane e Shqipërisë	1479742	1479742
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	1434012	1378845
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	1098180	1085407
Partia Lëvizja për Ndryshim	899816	807386
Partia Nisma Thurje	500000	500000
Partia Lëvizja e Re	431342	431342
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	150000	145018.5
Partia Balli Kombëtar	118011	108011
<b>Totali</b>	<b>293020608.1</b>	<b>286116820.6</b>

Në fushatën zgjedhore për zgjedhje të përgjithshme parlamentare, 12 parti politike vunë në dispozicion të fushatës, të ardhura në vlerën 293 020 608 lekë. Totali i Shpenzimeve të Deklaruara është 286 116 821 Lekë.

Partia Socialiste, Parti në qeverisje në datën e zgjedhjeve dhe fituese e tyre ka shënuar të ardhurat më të mëdha në fushatë ose rreth 60% të totalit të të ardhurave. Partia Demokratike ka arritur që të grumbullojë vetëm 47 625 660 lekë ose e thënë si përqindje ndaj totalit, 16.25%. LSI ka arritur që të sigurojë fond të barabartë me 35 955 359 lekë ose e shprehur ndaj totalit, 12.3%. Partia e katërt me madhësinë e fondeve

<sup>4</sup> ODA, Aksesuar online në linkun: <https://ndiqparate.al/?p=17986>

është Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Kjo parti ka arritur që të sigurojë 16 385 217 lekë ose sa 5.6% të totalit të fondeve të mbledhura nga të gjitha partitë politike.

E njëjta ecuri si me të ardhurat vihet re edhe tek shpenzimet e bëra përgjatë fushatës zgjedhore 2021. Partia Socialiste ka shpenzuar vlerën më të lartë të ardhurave të saj. Ajo ka shpenzuar e vetme sa 60.13% të shpenzimeve totale të bëra nga të gjitha partitë politike. Përkatësisht kjo vlerë e shpenzimeve për partinë dhe kandidatët e saj është 172 046 612 lekë.

### Burimet:

Sipas nenit 86 të Kodit Zgjedhor, Partitë Politike mund të financohen nga 4 burime: 1) Fondet Buxhetore, 2) Të ardhurat e vetë subjektit, 3) Dhuratat në vlerë monetare, në natyrë apo shërbime të dhëna sipas nenit 92/1 të Kodit zgjedhor dhe 4) Kreditë e marra nga Partitë Politike ose kandidatët sipas ligjit.

Partia	Buxheti I Shtetit	Kontributi i kandidatëve	Donacione	Të krijuara nga vetë partia
Partia Socialiste	55,826,750	38,628,598	5,101,905	76,980,834
Partia Demokratike	33,318,149	2,103,625	1,481,321	10,722,565
Lëvizja Socialiste për Integrim	18,975,182	-	8,769,344	15,757,046
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	5,552,885	-	315,940	10,516,392
Partia Republikane e Shqipërisë	3,926,232	-	309,208	0
Partia Bindja Demokratike	1,485,550	-	800,000	0
Partia Fryma e Re Demokratike	2,188,832	-	66,000	0
Partia Social Demokrate	1,629,360	-	0	0
Partia Demokristiane e Shqipërisë	1,479,742	-	0	0

Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	1,434,012	-	0	0
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	0	-	1,098,180	0
Partia Lëvizja për Ndryshim	0	-	899,816	0
Partia Nisma Thurje	0	-	500,000	0
Partia Lëvizja e Re	0	-	431,342	0
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0	-	150,000	0
Partia Balli Kombëtar	0	-	118,011	0
<b>Totali</b>	<b>125,816,694</b>	<b>40,732,223</b>	<b>20,041,067</b>	<b>113,976,837</b>

Kështu Partitë Politike në vend kanë shfrytëzuar të gjitha këto mënyra për të siguruar fonde sa më të mëdha përgjatë fushatës zgjedhore 2021.

Dhjetë parti kanë arritur që të përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit. Partia Socialiste ka arritur që të përfitojë pjesën më të madhe të fondeve të Buxhetit të Shtetit, përkatësisht, 55 826 750 lekë, ose sa 44.37% e Buxhetit Total të Shtetit për parti politike gjatë fushatës zgjedhore 2021. Partia Demokratike ka një shumë të barabartë me 33 318 149 lekë, ose 26.48% të totalit. Lëvizja Socialiste për Integrim 18 975 182 lekë, ose sa 15.08% e totalit.

Partitë politike kanë përfituar edhe nga Kontributi i vetë kandidatëve të tyre, Donacionet dhe Të Ardhurat e krijuara nga vetë Partia.

Financim nga burimet e vetë partisë kanë vetëm 4 partitë Partia Socialiste ka financim nga burimet e veta në vlerën 76 980 834 lekë ku 51 141 673 lekë janë financim nga vetë partia dhe pjesa tjetër 25 839 161 janë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë. Partia Demokratike të gjithë të ardhurat e krijuara nga burimet e vetë partisë, 10 722 565 lekë, i ka me burim nga kuotat e anëtarësisë. Lëvizja Socialiste për integrim ka arritur që të sigurojë të ardhura nga burimet e vetë partisë më shumë se Partia Demokratike, duke kaluar kështu në vend të dytë.

Përkatësisht LSI ka siguruar të ardhura në vlerën 15 757 046 lekë, ku 13 599 892 lekë, janë financim nga vetë partia fonde të mëparshme dhe 1 824 760 lekë financim nga kuotat. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet ka fond nga burimet e veta në vlerë pothuajse të barabartë me Partinë Demokratike. Kështu, PDIU, ka siguruar 10 516 392 lekë, ku 10 163 494 lekë e kanë burimin nga fonde të vetë partisë dhe pjesa tjetër 352 898 lekë nga kuotat e anëtarësisë.

Shpenzime për konsulencë ka kryer PS, 15 502 500 lekë, PD, 8 610 000 lekë dhe LZHK, 150 000 lekë.

Partitë politike kanë përfituar edhe donacione private. Përsëri Partia Socialiste ka përfituar vlerën më të madhe të dhurimeve. Kështu ajo ka përfituar 5 101 905 lekë donacione, ku 4 101 905 janë donacione në natyrë dhe pjesa tjetër në para. Partia Demokratike ka përfituar vlerën e dytë më të madhe të donacioneve, 1 481 321 lekë. E gjithë kjo vlerë është dhurim në natyrë. LSI ka përfituar vlerën e tretë më të lartë, 1 223 130 lekë. Partia e katërt që ka përfituar më shumë donacione është Partia Agrare Ambientaliste, 1 085 407 lekë. Shumica e dhurimeve janë në natyrë.

#### Kategoritë kryesore të shpenzimeve:

Partia	Partia Socialiste	Partia Demokratike	Lëvizja Socialiste për Integrim
<b>Aktivitetet/ mitingjet e fushates</b>	35687358	147732	5080494
<b>Materiale Promocionale</b>	7339061	7260000	15711588
<b>Media</b>	50470701	20564624	591120
<b>Media Sociale</b>	10707609	6715528	2320616
<b>Botime</b>	100000	0	1531970
<b>Transport</b>	3530978	438000	688031
<b>Zyra Elektorale</b>	4216200	0	2277067
<b>Dhurime në Natyrë</b>	4101905	0	15300686
<b>Administrative</b>	6226439	1786150	0
<b>Konsulenca</b>	15502500	8610000	0
<b>Sondazhe</b>	0	0	0
<b>Shpenzime të tjera (Kandidatë)</b>	-	2103626.14	-



Kategoritë kryesore të shpenzimeve, për tre partitë kryesore gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, janë të listuara si më sipër. Partia Socialiste ka shpenzuar më tepër për zërin "media" në vlerën 50,470,701 lekë ose rreth 37% të totalit të shpenzimeve, ndjekur nga aktivitetet për mitingjet e fushatës rreth 26% e shpenzimeve, konsulenca me 11%, mediat sociale me 8% dhe pjesa tjetër e zërave zënë më pak se 5% të totalit të shpenzimeve. Partia Demokratike gjithashtu ka shpenzuar më shumë për zërin "media", ndjekur nga konsulencat, materialet promocionale dhe media sociale. Ndërsa, partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka shpenzuar më tepër për "materiale promocionale", ndjekur nga "dhurime në natyrë", "mitingjet e fushatës" dhe "media sociale".

## Përmbledhje

- Shqipëria është në prag të zgjedhjeve lokale të vitit 2023 dhe një nga problemet më të mëdha vijon të mbetet financimi i fushatave zgjedhore. Në kuadër të transparencës së financimeve në zgjedhje, KQZ në një raport të fundit për zgjedhjet e vitit 2021, konstatoi se kishte fshehje të dukshme të burimeve të financimit dhe shpenzimeve
- Disa nga problemet kryesore që shfaqen nga mungesa e transparencës: Rrezik korrupsioni për cilësinë e qeverisjes dhe të demokracisë; Bie ndesh me parimet demokratike të konkurrencës së ndershme në zgjedhje dhe mund të cënojnë edhe përfaqësimin politik; Rrezikohet më tej besimit të politika dhe politikanët
- Disa nga arsyet se pse është e domosdoshme përmirësimi i mëtejshëm ligjor dhe praktikave monitoruese (sanksionet) të financimit të partive politike: Parandalimi i abuzivizmit; Fuqizimi i një konkurimi politik të drejtë; Fuqizimi i votuesve nëpërmjet rregullave ligjore të transparencës dhe ndërkohë; dhe Fuqizimi i partive politike si aktorë efektivë të demokracisë nëpërmjet rritjes së integritetit dhe demokracisë së brendshme.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Ai financohet nga Buxheti i Shtetit dhe është institucion i pavarur. Referuar buxhetit të konsoliduar fillestar (periudha 2008-2023), viti 2019 renditet si vitit me buxhetin më të lartë të parashikuar, me 762.1 milionë lekë. Kjo shumë është më e larta e parashikuar ndonjëherë.
- Masat administrative, për partitë politike për raportimin e vitit 2020, para ankimimit: gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike, që nuk kanë

dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin kalendarik 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për 4 (katër) partitë politike që e kanë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Problematikat e shfaqura ndër vite në lidhje me financimin e partive: Partitë e mëdha kanë deklaruar si dhurim në natyrë; Donatorët në natyrë për këtë kategori shpenzimi mbeten anonim pasi partitë nuk kanë bërë evidentim me faturë të rregullt për këto lloj dhurimesh (në natyrë); Mos mbajtja e faturave të rregullta për rastet është shkelje e rregullave të kontabilizimit dhe evidencës së raportit financiar; Partitë deklarojnë pak të ardhura të vënë në dispozicion për fushatën dhe këto kryesisht të ardhura të cilat janë financime publike nga buxheti i shtetit; Një fakt shqetësues është edhe marrëdhënia ndërmjet subjekteve elektorale dhe mediave; Partitë politike kanë vlera të ndryshme në raportimet e bëra në faqen e KQZ (on line) dhe në deklaratimet e bëra përmes raporteve të auditimit kontabël.
- Në mbikqyrjen e financave të partive, përveç KQZ kanë rol dhe institucione të tjera si Prokuroria, Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe se depërtimi i parave nga bota e krimit dhe korrupsionit në fushatë mbetet shqetësim dhe duhen marrë masat e nevojshme nga autoritetet përgjegjëse.

## Bibliografia

Albanian Institute of Science (2014) "FINANCING OF POLITICAL PARTIES IN ELECTORAL CAMPAIGNS." Available at: <https://ais.al/new/wp-content/uploads/AIS-The-Electoral-Room-for-Reform-Policy-Paper.pdf>.

"Dekriminalizimi." KQZ, 21 Feb. 2023, <https://kqz.gov.al/dekriminalizimi/>.

ODA. "Para Të Buxhetit Të Shtetit Akorduar Si Fond Vjetor Për Partitë Politike Viti 2022." *Open Data Albania*, 14 Sept. 2022, <https://ndiqparate.al/?p=18009>.

Republika e Shqipërisë - Kqz.gov.al. <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Raporti-OSBE-ODIHR-2021.pdf>.

Erebara, Gjergj. "Financimi i Fushatave Elektorale, Një Hap Para, Gjysmë Hapi Pas." <https://www.reporter.al/>.

Picari, Mimoza. "Shqipëri, Ekspertët Shqetësim Për Burimet e Financimit NË Zgjedhje." VOA, Zëri i Amerikës, 3 Mar. 2023, <https://www.zeriamerikes.com/a/6988728.html>.

Republika e Shqipërisë - Kqz.gov.al. <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Raporti-OSBE-ODIHR-2021.pdf>.

Baze, Mero. *Gazeta Tema*, <https://www.gazetatema.net/>.

Ligj Nr. 8580, Datë 17.2.2000 Për Partitë Politike ... - Kqz.gov.al. [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020\\_1.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020_1.pdf).

"Buxheti Në Vite." *Ministria Financave Dhe Ekonomisë*, <https://financa.gov.al/buxheti-ne-vite/>.



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)